

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Tiranë, më 18.07.2024

### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i Procedurës:** Marrëveshje Kuadër me objekt “Blerje pajisje dhe mobilim për shtëpizat e mbështetura burra dhe gra” për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë e ndarë në 2 (dy) lote.

- Loti I: “Blerje pajisje mobilimi për shtëpizat e mbështetura burra dhe gra” për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj.
- Loti II: “Blerje televizorë” për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj.

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):** 39150000-8

**Vlera e Fondit Limit/vlera e pritshme e kontratës:** Marrëveshje kuadër me objekt “Blerje pajisje dhe mobilim për shtëpizat e mbështetura burra dhe gra” për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë, me vlerë të përgjithshme të fondit limit **34,941,298** (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH** ose 348,298 (treqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 18.07.2024 është 100.32) e ndarë me 2 (dy) Lote si më poshtë:

- **Loti I “Blerje pajisje mobilimi për shtëpizat e mbështetura burra dhe gra”** për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj me fond limit 33,397,648 (tridhjetë e tre milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë) lekë pa TVSH ose 332,911 (treqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 18.07.2024 është 100.32)

- **Loti II “Blerje televizorë”** për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 1,543,650 (një milion e pesëqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH ose 15,387 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 18.07.2024 është 100.32)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e organit qendror blerës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Loti I “Blerje pajisje mobilimi për shtëpizat e mbështetura burra dhe gra”** për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit të tretë me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” AK nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të

kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: .....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses.

2. Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues** ose sipas tabelës 2 nëse është **tregtues i autorizuar nga prodhuesi** ose **distributori i autorizuar nga prodhuesi** për mallrat objekt prokurimi.

**Tabela 1.** Forma e deklarimit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit
1		
2		
Etj.,		

**Tabela 2.** Forma e deklarimit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi
1			
2			
Etj.,			

Operatori ekonomik që oferton si tregtues, përveç deklaratës së mësipërme, duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose autorizim nga Distributor i autorizuar nga prodhuesi, për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, eëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime orendish dhe pajisjesh të ndryshme mobilimi, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Duke marrë parasysh edhe institucionin kërkues Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë është e rëndësishme që autoriteti kontraktor të sigurohet se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë kontratën sipas cilësisë, afatit dhe kërkesës së AK përfitues.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose fragmente të katalogut të prodhuesit/ve për mallrat me numër rëndor **nr.2, nr.4, nr.5, nr.6, nr.9, nr.10**, sipas numrit rëndor në shtojcën nr. 6 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të Lotit 1, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike,

të mallrave objekt prokurimi. Nëse katalogu/ët janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 6/b të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri Autoriteti Kontraktor kërkon dokumentet katalogë apo fregmente katalogesh me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallit të ofruar nga operatorët ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kjo krijon siguri për Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë ofertojnë mallra sipas specifikimeve teknike dhe cilësisë së kërkuar. Katalogu/ fragmente të katalogut janë kërkuar vetëm për disa artikuj duke marrë në konsideratë sasine dhe vlerën e tyre.*

4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit dhe montimin e mallrave pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor përfitues brenda afatit të parashikuar.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.*

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet** për transportin në destinacion të mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për metin sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qera/huapërdorje

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik i vlefshëm, policia e sigurimit të vlefshëm të mjetit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira/huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik (e vlefshme), si dhe policia e sigurimit të mjetit (e vlefshme).

**Shënim:** *Kriteri nr.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh llojin e mallit që do të transportohet, aftin e marreveshjes kuadër që është deri në 24 muaj.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) persona të punësuar, për realizimin e objektit të prokurimi, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Punonjës i thjeshtë	4
2.	Shofer	1
	<b>Total</b>	<b>5</b>

Për punonjesit e thjeshte te paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme.

Per punonjesin shofer te paraqitet:

- Leja përkatëse e drejtimit të mjetit (e vlefshme)
- Kontrate pune e vlefshme.

**Shënim:** Kriteri Nr.6 konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 5 punonjësish, përkatësisht një shofer dhe kater punëtorë të thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe kater punonjës për shkarkimin e vendosjen e mallrave në ambientin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor dhe shërbimeve të tjera ndihmëse në funksion të realizimit të kontratës. Numri i punonjesve te kerkuar eshte minimal, duke marre ne konsiderate, sasine, llojin e mallit objekt prokurimi.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën 1 vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë

riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve që mund të vijnë për shkak të prodhimit dhe montimit.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë.*

**Shenim:** *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **LOTI II “BLERJE TELEVIZORË” PËR DREJTORINË E SPITALIT PSIKIATRIK “ALI MIHALI” VLORË**

### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**



## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: "Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**" dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar" duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën vlerën e kufirit të ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.*

*Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e dytë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar nenit 42/3 dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun ose fragmente të katalogut të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi për lotin 2 (dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip) ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallrave që do të ofrohen, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara në dokumentat e tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 6/b të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri Autoriteti Kontraktor kërkon dokumentet katalogë me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallit të ofruar nga operatorët ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kjo krijon siguri për Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë ofertojnë mallra sipas specifikimeve teknike dhe cilësisë së kërkuar.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet** për transportin në destinacion të mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për metin sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qera/huapërdorje

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik i vlefshëm, polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira/huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik i vlefshëm, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.

**Shënim:** Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh llojin e mallit që do të transportohet, afatin e marreveshjes kuadër që është deri në 24 muaj.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 2 (dy) persona të punësuar, për realizimin e objektit të prokurimit, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Punonjës të thjeshtë	1
2.	Shofer	1
	<b>Total</b>	<b>2</b>

Për punonjesin e thjeshte te paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme.

Per punonjesin shofer te paraqitet:

- Leje pekatese e drejtimit te mjetit e vlefshme.
- Kontrate pune e vlefshme.

**Shënim:** Kriteri nr.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht një shofer dhe një punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe një punonjës për shkarkimin e vendosjen e mallrave në ambjentin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor dhe shërbimeve të tjera ndihmëse në funksion të realizimit të kontratës. Numri i punonjësve të kërkuar është minimal, duke marrë në konsideratë, sasine, llojin e mallit objekt prokurimi.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e mallrave objekt prokurimi si më poshtë:

-Afati i garancisë do të jëtë sipas afatit të përcaktuar në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” për lotin 2, për secilin nga mallrat objekt prokurimi.

-Mallrat objekt prokurimi do të shoqërohen më fletë garancie në momentin e dorëzimit të tyre pranë Autoritetit Kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë për shkak që vijnë nga prodhimi, të kryhet zëvendësimi ose riparimi i tyre pa pagesë.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë furnizimin/vendosjen/montimin e mallrave objekt prokurimi në adresen e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë furnizimin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

**Shenim:** Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike

*për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër. Konkretisht, në rastin e ankesës/ave, procedura e shqyrtimit të ankimit në KPP për një lot, nuk ndikon tek loti tjetër. Autoriteti vijon me referencën e procedurës konkrete, pa cënuar të drejtat e operatorëve ekonomikë**

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike për të tre lotet:**

Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktues kerkues, sipas nevojave të tyre për blerje orendi dhe pajisje të ndryshme mobilimi.

**Shënim:** *Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.*

Data e publikimit të njoftimit është **19.07.2024** dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është **19.08.2024 ora: 11:00** në faqen e internetit [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.